




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 218/22

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Kimete Gashi – Kryetare, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK-KK Gjakovë me numër 218/22, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE "LC Group" SH.P.K - Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material ndërtimor për klasën verore SHFMU Ukshin Miftrari-Ri-tender", me numër të prok: 632-21-8137-1-3-6, më: 02 Nëntor 2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET, si e pa bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues– Kuvendi Komunal Gjakovë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "LC Group" SH.P.K - Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material ndërtimor për klasën verore SHFMU Ukshin Miftrari-Ri-tender", me numër të prok: 632-21-8137-1-3-6. Udhëzohet AK të vazhdojë sipas dispozitave të LPP-së.

A R S Y E T I M

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me datën 08 Prill 2022, Autoriteti kontraktues- Kuvendi Komunal Gjakovë, ka dorëzuar në OSHP kërkesën për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP-së, ndaj OE: "LC Group" SH.P.K - Rahovec.

Me datën 12 Prill 2022 eksperti shqyrtues ka pranuar autorizimin lidhur me përgatitjen e një kronologjie lidhur me kërkesën e AK- Kuvendi Komunal Gjakovë, ku ka sqaruar:

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Autoriteti kontraktues- KK- Gjakovë me seli në Gjakovë, me datë 8 prill 2022 ka parashtruar kërkesë në OSHP, për të aplikuar dispozitat e nenit 99 pika 2 të LPP-së, ndaj OE: “LC Group” SH.P.K.- Rahovec, me numër unik identifikues 811592121, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material ndërtimor për klasën verore SHFMU Ukshin Miftari-Ri-tender”, me numër të prok: 632-21-8137-1-3-6 , nga pjesëmarrja në prokurim public për një periudhë deri në një vjeçare për arsye sepse nga njëjti nuk është përfunduar aktiviteti i prokurimit sipas kontratës së nënshkruar nga ana e operatorit ekonomik sipas Autoritetit Kontraktues.

Kuvendi Komunal Gjakovë, me datën 22.11.2021, ka lidhur kontratë me OE: “LC Group” SH.P.K.-Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material ndërtimor për klasën verore SHFMU Ukshin Miftari-Ri-tender”, me numër të prok: 632-21-8137-1-3-6.

Autoriteti Kontraktues disa herë kanë marrë urdhëresë nga Menaxheri i Kontratës z. Shefqet Dinaj, për realizimin e furnizimeve- punëve, konform kushteve të kontratës dhe OE nuk janë përgjigjur. Gjithashtu Menaxheri i Kontratës z. Shefqet Dinaj, përmes komunikimeve zyrtare e-mailave, shkresave disa herë i ka tërhequr vërejtjen se nëse nuk fillojnë me realizimin e kontratës do të kërkohet shkëputja e saj nga Zyra e Prokurimit. Këtu kemi vërejtjet e datës 13.01.2022, 14.01.2022 dhe 11.03.2022, mirëpo përkundër vërejtjeve të shumta, OE, nuk ndërmori veprime të nevojshme për përmirësimin e kualitetit dhe dinamikës për realizimin e furnizimeve të punëve për realizimin e kontratës.

Operatori Ekonomik në fjalë, nuk ka bërë realizimin e punëve, konform kushteve të kontratës dhe nuk iu është përgjigjur urdhëresave për fillim të punimeve dhe nuk i është përgjigjur e-mailave, të Menaxherit të kontratës. Edhe pse përkundër faktit se kontrata ishte me plan dinamik që të përfundohet për tre javë nga data 24.11.2021, deri me datën 15.12.2021 të njëjtit veç se kishin hapur katër gropa dhe në të cilat janë vendosur edhe armatura e skeletit, dhe më nuk janë paraqitur në vend punim.

KK-Gjakovë, në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së dhe nenin 28, paragrafi 28.1 nën a), b) dhe c), të kontratës:

Me dt.06.04.2022, Autoriteti Kontraktues ka ndërprerë kontratën e lidhur për aktivitetin prokurimit: “Furnizim me material ndërtimor për klasën verore SHFMU Ukshin Miftari-Ri-tender”, me numër të prok: 632-21-8137-1-3-6. Me këtë kërkesë inicion procedurën për diskualifikim të OE në fjalë.

KK-Gjakove, kërkon nga OSHP zbatimin e nenit 99.2 për arsye se OE: “LC Group” SH.P.K.-Rahovec, nuk ka bërë realizimin e punëve, konform kushteve të kontratës dhe nuk iu është përgjigjur urdhëresave për fillim të punimeve dhe e-mailave, nga Menaxherit të kontratës.

Eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 99.2 të LPP-së, dhe neni 26.8 i RrUOPP-së marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit nuk e kanë përfunduar plotësisht aktivitetin e prokurimit dhe kanë shkelur kontratën e nënshkruar ose kanë prezantuar dokumente të falsifikuara ose nuk e përmbushin kontratën e nënshkruar në dispozitat ligjore, e në këtë rast shihet qartë për një gjë të tillë nga ana e operatorit ekonomik sepse nuk e kanë përfunduar këtë aktivitet të prokurimit sipas kontratës së nënshkruar. Ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, në të cilin thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me mos përfundimin e një kontratë të nënshkruar apo të ngjashme nga ana e operatorëve ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Edhe pse janë ftuar të marrin pjesë në një seancë dëgjimore palët e përfshira në këtë procedurë nuk janë paraqitur madje nuk kanë kthyer as përgjigje me shkrim ndaj ftesës për pjesëmarrje në seancë. Paneli shqyrtues konstaton se AK nuk ka arritur të dëshmojë me prova se OE i lartpërmendur ka prezantuar dokument të falsifikuar ose paraqitje të dhënave të rreme, AK duhet të vazhdojë me implementim të kontratës.


Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal Gjakovë;
- 1x1 OE – “LC Group” SH.P.K - Rahovec;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.


Kryetar i Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi